



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës  
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Në bazë të paragrafit 6 te nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 63 paragrafi 63.1.3 pika (a) lidhur me paragrafin 63.1.2 të Rregullorës 01/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 17.04.2023 të paraqitur nga Operatori Ekonomik "GeoFIX" SH.P.K. nga Prishtina, bie këtë :

## VENDIM

I

Çikış - Dalëse - Izlazna - Outgoing	
02	No.Nr. 075 - 2023
Tarih/Dt. 20.04.2023	

Refuzohet **si e pa bazuar** kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik "GeoFix" SH.P.K nga Prishtina e parashtruar në mënyrë elektronike përmes platformës me datën 17.04.2023 për aktivitetin e prokurimit me numër: 626-23-991-2-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-23-002-2-2-1 me titull: Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë

II

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

## ARSYETIM

Operatori ekonomik "GeoFix" SH.P.K nga Prishtina me datën 17.04.2023 përmes platformës elektronike, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit për anulim të procedurës nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Maushës për projektin me titull: Shërbime për matjet kadastrale në Mamushë

Si autoritet kontraktues pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, menjëherë kemi bërë pezullimin e kësaj procedure dhe brenda afatit ligjor me kujdes të shtuar, kemi shqyrtaur të gjitha pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë i kemi paraparë kërkesat të cilat duhet ti plotësojnë Operatorët Ekonomik për të qenë të përgjegjshëm, andaj vlerësimi është bërë në bazë të legjislacionit të LPP-s si dhe në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Në pretendimet e O.E. është cekur se janë bërë shkelje të neneve 1; 6; 7; 59; 61 dhe 72 të LPP-s si dhe neni 40 dhe 38 të RrUOP. Konsiderojmë që të gjitha këto pretendime të shkeljes së LPP-s dhe rregullores (me ç'rast O.E. ju ka referuar rregullave dhe udhëzuesit të shfuqizuar), janë të pa baza për arsyet e cekura në vijim.

Pretendimi i O.E. që ne nuk kemi siguruar shfrytëzimin e mjeteve në mënyrë të drejtë dhe efikase, duke shpenzuar mjete financiare në mënyrë jo të drejtë dhe se është shkelur neni 1 i LPP-s nuk qëndron, pasi që ne si Autoritet Kontraktues e kemi zhvilluar procedurën në fjalë duke u bazuar në dispozitat e nenit 1 si dhe në dispozitat tjera të LPP-s në mënyrë të hapur dhe transparente. Pra pretendimi nuk qëndron pasi që në tërësi janë respektuar dispozitat e këtij neni. Do të vinte në shprehje shkelja e këtij neni po që se O.E. ankues do të kishte dorëzuar tender të përgjegjshëm, në përshtatje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe nëse do të kishte dorëzuar ofertën më të lirë në mesin e tenderuesve

pjesëmarrës në këtë tender, mirëpo me qenë se nuk i ka plotësuar kërkesat në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë si dhe ka ofruar çmimin pothuajse më të lartë në mesin e tenderuesve pjesëmarrës, eshtë konsideruar si O.E. i pa përgjegjshëm.

Edhe neni 6 eshtë i ndërlidhur me nenin 1 pasi që procedura në fjalë eshtë anuluar dhe nuk eshtë shpërblyer me kontratë ndonjë Operator Ekonomik i cili ka dorëzuar ofertën më të lartë se O.E. ankues, prandaj konsiderojmë që edhe ky pretendim eshtë i pa bazë.

Sa i përket pretendimit se janë shkelur dispozitat e nenit 7 të LPP-s, edhe ky pretendim nuk qëndron pasi që procedura eshtë zhvilluar në mënyrë të hapur dhe transparente. Vlerësimi eshtë bërë në mënyrë profesionale duke i trajtuar të gjithë O.E. në mënyrë të barabartë. Operatori Ekonomik ankues këtu eshtë thirrur sikur ne e kemi shpërblyer me kontratë ndonjë pjesëmarrës në tender, mirëpo ne e kemi anuluar procedurën në fjalë për shkak se nuk kemi pranuar asnjë ofertë të përgjegjshme andaj edhe pretendimi që eshtë shkelur neni 7 i LPP-s nuk qëndron.

Edhe pretendimi se eshtë shkelur neni 59 i LPP-së, eshtë i pa bazë dhe i pa qëndrueshëm, pasi që në dispozitat e këtij neni në paragrafin 4 eshtë paraparë që Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi, në fjalë eshtë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e paraqitura në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë tek Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) në nenin 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitet teknike dhe/ose profesionale në pikën 2. eshtë paraqitur kushti si vijon:

**2. OE duhet të kenë staf të mjaftueshëm të punëtorëve dhe inxhinierëve të kyçur në projekt, minimumi 2.1 Një ing. i dip. i gjeodezisë ose master të perfunduar i cili duhet të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në shërbime të ngjashme dhe të jetë i licencuar nga Agjencioni Kadastral i Kosovës ose organi kompetent në vendin e lëshimit të një licence të tillë. 2.2 Një (1) Bachelor të gjeodezisë, së paku 3 (tre) vite përvojë punë në shërbime të ngjashme.**

**Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

**2. • Lista e punëtorëve të O.E. • Diplomat përkatëse të punëtorëve dhe inxhinierëve të paraqitur në listë sipas kërkesës • Cv-ja e punëtorëve dhe inxhinierëve e nënshkruar nga vetë personi (original ose kopje e noterizuar) • Kontratat valide të punës - Kopje.**

Ju keni dorëzuar listën e stafit dhe diplomat e inxhinierëve të kërkuar mirëpo CV-ja e inxhinierit Ibrahim Junuzi e paraqitur nga ana juaj, nuk eshtë nënshkruar nga vetë inxhinieri sikur eshtë kërkuar më lartë andaj CV-ja nuk e ka plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues.

Duke u bazuar në nenin 10 paragrafin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023, ne paraqiten tabelore shprehimisht eshtë paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Kërkesa nga ana e AK-s ka qenë e qartë që për të qenë e vlefshme, Cv-ja e punëtorëve dhe inxhinierëve duhet të dorëzohet e nënshkruar nga vetë personi (original ose kopje e noterizuar)

Arsyjetimi se AK ka mundur të kërkoj informacione shtesë sepse në dy pika tjera të Udhëzuesit të Prokurimit, eshtë paraparë që nëse mungon CV-ja mund të kërkojnë informacione shtesë si dhe nëse CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuar, AK nuk mund të vendos, mund të kërkojnë informatat sqaruese, eshtë i pa qëndrueshëm dhe i pa bazë pasi që vetë O.E. ankues ka dorëzuar CV-në për inxhinierin në fjalë e cila i ka përbajtur shënimet e caktuara me të cilat sipas shënimeve janë vendosur informatat e kërkuar që inxhinieri eshtë i licencuar dhe ka përvojën 5 vjeçare, mirëpo CV-ja e

dorëzuar nuk i ka përbushur kërkesat që të jetë e nënshkruar nga vetë inxhinieri. Prandaj edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazë.

Edhe pretendimi që është shkelur nen 61 i LPP-s është i pa bazë pasi që nuk janë plotësuar kushtet që të kerkohet sqarim në lidhje me tenderin jo normalisht të ulët sikur është paraparë në nenin 61 të LPP-s dhe Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, nen 41 sepse nuk ka pasur asnjë O.E. të përgjegjshëm për ti kerkuar sqarim në lidhje me tenderin jo normalisht të ulët.

Më tej Operatori Ekonomik ka pretenduar që janë shkelur edhe dispozitat e nenit 72 të LPP-s me arsyetimin se Autoriteti Kontraktues ka mundur që të kerkoj sqarim në lidhje me mos nënshkrimin e CV-s nga inxhinieri. Mirëpo në paragrin 3 të nenit 72 shprehimisht është paraparë që: Citat “Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencia e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.” Pra sikur shihet më lartë, nuk mund të kerkohet informacion për një dokument sikur është nënshkrimi i CV-s pasi që nënshkrimi është dashur që të vendoset në CV para dorëzimit të tenderit. Andaj legjislacioni e ka paraparë qartë situatën në fjalë e për më tepër në nenin 10 paragrin 10.1 të Udhëzuesit të Prokurimit Publik nr. 001/2023, ne paraqitjen tabelore shprehimisht është paraparë që në rast se CV-ja nuk i plotëson kërkesat e AK-s (që në rastin tonë ka qenë i obligueshëm nënshkrimi i CV-s nga vetë inxhinieri), refuzo tenderin pa kerkuar informacion të mëtejshëm. Pra sikur shpjeguam më lartë edhe ky pretendim është i pa qëndrueshëm dhe i pa bazë.

Gjithashtu kërkesa në përshkrimin e çmimit ka qenë e qartë në të cilën është paraqitur njësia dhe sasia dhe është kerkuar që të vendoset çmimi për metër katror ( $m^2$ ) apo njësit tjera sipas pozicioneve të kerkuara. O.E. ankues ka qenë i obliguar që të jep çmimin për metër (m) sikur është paraparë në përshkrimin e çmimit sepse çmimi për njësi është çmimi bazë i cili nuk mund të ndryshohet dhe se çmimet janë vendosur me metër katror apo njësi tjera me qëllim që Autoriteti Kontraktues të marrë çmime më të lira në rastin kur matjet e parcelave. Ndërsa ju keni vendosur çmime të cilat duke e kalkuluar vetëm pozicionin e parë të përshkrimit të çmimit e tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës.


Sa i përket dëmeve materiale për të cilat O.E. pretendon se i janë shkaktuar, në dosje të tenderit shprehimisht është cekur se AK nuk i mbulon shpenzimet të cilat i bëjnë tenderuesit me rastin e përgatitjes dhe dorëzimit të tenderit të tyre. O.E. ankues ka paraqitur disa shpenzime me qëllim të përfitimit të pa bazë dhe të pa drejtë. Andaj konsiderojmë se edhe ky pretendim është i pa bazë.

**Andaj,**

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mamushë, me dt 20.04.2023

Gazmend Gashi  
Udhëheqësi i sektorit të prokurimit  
Komuna Mamushës



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë pranë **Organit Shqyrtares të Prokurimit (OSHP)** brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.